

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 5430726

Nr. i fq. / Br. st. - 9 -

Data: / Datum: 04. 02. 2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-25/26 04.02.2026

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRIË, MBAJTUR MË: 30 DHJETOR 2025

Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Pllumb Maliqi Ramadan Parduzy, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Ferit Idrizi, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 31 anëtarë të kuvendit kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Pas shqyrtimit të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime", aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete;
3. Propozim-vendim për aprovimin e listës së pronave komunale për vitin 2026;
4. Draft Plani i Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026;
5. Draft Plani i Punës i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026;
6. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25196/25 i datës 03.06.2025, për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private,

zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzy" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike;

7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25199/25i datës 03.06.2025, Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës te SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike;
8. Propozim-vendim për anulimin e vendimit me numër të protokollit Nr. 108/24 i datës 03.06.2024, lidhur me pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.
9. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 18/25 i datës 30.01.2025, me të cilin lejohet ndarja e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore;
10. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 29309/25 i datës 26.06.2025 lidhur me miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri;

1. Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-pasi përshëndeti anëtarët e kuvendit dhe gjithë të pranishmit, iu uroj zgjedhjen të gjithë anëtarëve të ri në mandati katër vjeçar 2025-2029. Po ashtu uroj fitoren Lëvizjes Vetëvendosje për rezultuan që kanë arritur në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, duke uruar që sa më shpejtë të formohen institucionet shtetërore të Republikë së Kosovës. Ai shprehur gatishmërinë dhe zotimin e tij për bashkëpunim ndër institucional dhe premtoj se si gjithëherë do të jetë bashkëpunues me kuvendin dhe do ti përgjigjet kuvendit me përgjegjësi dhe në të mirën e interesit të përgjithshëm qytetarë. Në fund në emër të kryetarit të komunës së Vushtrrisë iu uroj të gjithë qytetarëve të komunës vitin e ri 2026 duke ju dëshiruar shëndet e mbarësi !

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-fillimisht përshëndeti gjithë të pranishmit, dhe iu uroj anëtarëve të ri të zgjedhur në mandatin 4 vjeçar 2025-2029, duke ju uruar sukses shëndet e punë të mbarë. Tutje ajo sqaroi se Komitetit për Politikë dhe Financa do të përbëhet nga 7 anëtarë, nga tri subjektet më të mëdha politike të përfaqësuara në kuvend, ndërsa pozita e kryesuese shkon sipas detyrës zyrtare. Prandaj PDK, do të përfaqësohet me tre anëtarë LVV me dy anëtarë dhe LDK me një anëtarë.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit- deklaroi se shefe e grupit kuvendar të Parisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë për mandatin 2025-2029 do të jetë znj. Vlerë Tahiri.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit- deklaroi se shef i grupit kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë për mandatin 2025-2029 do të jetë z.Refik Maloku.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit- deklaroi se shef i grupit kuvendar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë për mandatin 2025-2029 do të jetë z. Berat Sadiku.

Diellza Pllana, anëtare e kuvendit- deklaroi se shef i grupit kuvendar të Nismës Socialdemokrate në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë për mandatin 2025-2029 do të jetë z. Kushtrim Veseli.

Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit- në emër të grupit kuvendar të Parisë Demokratike të Kosovës, propozoj për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa z.Kushtrim Hyseni, z.Xhon Gubetini dhe znj.Blerina Shala.

Pas këtyre propozimeve, kuvendi pas votimit me 17 vota “për” asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” zgjodhi anëtarët e KPF-së nga radhët e subjektit politikë Partia Demokratike e Kosovës si në vijim: z. Kushtrim Hyseni, z. Xhon Gubetini dhe znj. Blerina Shala.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- në emër të grupit kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosje propozoj për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa znj. Fatmire Cecelia dhe z.Ymer Haradinaj.

Pas këtyre propozimeve, kuvendi pas votimit me 27 vota “për” asnjë “kundër” dhe 2 vota “abstenim” zgjodhi anëtarët e KPF-së nga radhët e subjektit politikë Lëvizja Vetëvendosje si në vijim: znj. Fatmire Cecelia dhe z.Ymer Haradinaj.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozon për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa z. Berat Sadiku.

Fakete Dushi, anëtare e kuvendit- nga Lidhja Demokratike e Kosovës propozoj znj.Gentiana Rama për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim dy propozimet: Berat Sadiku mori 13 vota “për” ndërsa znj. Gentiana Rama mori 16 vota “për” dhe kjo e fundit u zgjodh anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga radhët e LDK-së.

Në epilog të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota “për” 5 vota “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa nga radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës, në këtë përbërje:

- 1.1 Melihate Basholli Latifi, – Kryesuese e KPF (PDK);
- 1.2 Xhon Gubetini, anëtar i kuvendit, (PDK);
- 1.3 Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit, (PDK);
- 1.4 Blerina Shala, anëtare e kuvendit, (PDK);
- 1.5 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit, (LVV);
- 1.6 Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit, (LVV);
- 1.7 Gentiana Rama, anëtare e kuvendit, (LDK);

2. Komiteti për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë do t’i ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera si dhe rregulloren e punës.

3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa është i njëjte me mandatin e anëtarëve të kuvendit të komunës përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Anëtarët e KPF-së, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

5. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

2. Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete;

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-sqaroi se pika 1.7 e këtij propozim-vendim ndryshohet, ku në vend të përfaqësuesit të Komunitetit Boshnjak futet një anëtarë i kuvendit, pra pjesë e këtij komitetit do të jenë tri subjektet politikë të përfaqësuar me nga një anëtarë PDK-1, LVV-1 dhe LDK-1. Ndërsa tek komuniteti turk në vend të z. Erdal Kera, komunitetit e ka propozuar z. Berat Maloku.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-fillimisht ju uroj të gjithë anëtarëve të kuvendit zgjedhjen dhe rizgjedhjen në pozitat e anëtarit të kuvendit duke ju uruar suksese e punë të mbarë. Po ashtu ai iu uroj vitin e ri 2026 kuvendarëve dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete, pika 1.7 e këtij propozim ceket se anëtare e Komitetit nga komuniteti Boshnjak është Zana Krasniq-Saraçi, e po ashtu kërkoj të ndërrohet emri i përfaqësuesit të Komunitetit Turk. Prandaj nëse duam të kemi transparencë lidhu me këtë proces atëherë është mirë që kuvendi t'i ketë procesverbalet se si janë zgjedhur përfaqësuesit e këtyre komuniteteve që do të përfaqësojnë në komitetin për Komunitete. Pra me fjalë tjera nuk është kompetencë e kryesuese së kuvendit që të zgjedh se kone dëshiron ta lenë në komitet e kënd jo.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-sqaroi se nuk fare hezitim, dhe shtoj se përfaqësuesi i komunitetit boshnjak hiqet për shkak të numrit të vogël që jetojnë në Komunën e Vushtrrisë, ku janë vetëm 22 anëtarë të këtij komuniteti që jetojnë në Vushtri. Për më tepër procesverbalet duhet t' i kërkonin në zyrën për komunitete në Komunën e Vushtrrisë sepse ata janë përgjegjës për ti bërë propozimet. Në anë tjetër ky propozim-vendim deri në aprovimin e tij mund të pësoj modifikime dhe ndryshimet e nevojshme.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-pasi i uroj të gjithë anëtarët e kuvendit në marrjen e mandati të tyre, kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që të merret seriozisht me rregullimin e mikrofonave dhe kamerave në sallën e kuvendit ashtu që të krijohen kushte më të mira për anëtarët e kuvendit. Më tej kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që të reflektoj në udhëheqjen e kuvendit mos të vazhdoj me avazin e vjetër duke udhëhequr njëanshëm me kuvendit, sepse siç deklaroi edhe me themelimin e KPF-së, nuk mund që Partia Demokratike e Kosovës të caktoj përfaqësuesin e LDK-së në Komitetin për Politikë dhe Financa, sepse kjo është e papranueshme. LDK e ka të drejtën e propozimeve të veta dhe askush nuk mund të ja tjetërsoj të drejtën e saj për emrat e përfaqësuesve të vet në KPF. Në rastin e themelimit të Komitetit për Komunitete, ky propozim-vendim ka ardhur tek anëtarët e kuvendi para 7 dite dhe edhe atëherë ka qenë e ditur që komuniteti boshnjak ka pasur vetëm 22 qytetar në Vushtri, dhe është dashur të sqarohet qysh në fillim, po kjo si duke iu ka prishur matematikat e juaj politike dhe nuk po dini se si të veproni.

Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-deklaroi se Partia Demokratike e Kosovës në kuvend e propozon z.Behar Duraku për anëtarë të Komitetit për Komunitete.

Pas këtij propozimi, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” zgjodhi anëtar të Komitetit për Komunitete z. Behar Duraku nga radhët e subjektit politikë Partia Demokratike e Kosovës.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-deklaroi se abuzimi me numra në kuvendin e komunës, në fillim të këtij mandati është tepër keq dhe është e turpshme se si po vazhdohet me avazin e vjetër. Më tej shtoj se po manipulohet me emrat e përfaqësuesve të komuniteteve pakicë duke i ndërruar ata sipas dëshirës. Nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje për anëtare të Komitetit për Komunitete propozoj znj. Gresa Muli.

Lidhur me propozimin e sipër cekur kuvendi pas votimit 27 vota “për” asnjë “kundër” dhe 3 vota “abstenim” zgjodhi anëtare të Komitetit për Komunitete znj. Gresa Muli nga radhët e subjektit politikë Lëvizja Vetëvendosje.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- në emër të grupit kuvendar të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozon për anëtar të Komitetit për Komunitete z. Isak Uka.

Gentiana Rama, anëtare e kuvendit- propozoj znj. Fakete Dushi për anëtare të Komitetit për Komunitete.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim dy propozimet e cekur si më larë ku nga votimi rezultoi me sa vijon: z.Isak Uka, mori 9 vota “për” asnjë “kundër” asnjë “abstenim”, ndërsa znj. Fakete Dushi mori 16 vota “për” asnjë “kundër” asnjë “abstenim” dhe kështu kjo e fundit u zgjodh anëtare e Komitetit për Komunitete.

Në epilog të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 21 vota “për” asnjë “kundër” asnjë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Komunitete, i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- 1.1 Behar Duraku, anëtar i Kuvendit të Komunës;**
- 1.2 Gresa Muli, anëtare e Kuvendit të Komunës;**
- 1.3 Fakete Dushi, anëtare e Kuvendit të Komunës;**
- 1.4 Miljan Bojković, përfaqësues i komunitetit serb;**
- 1.5 Aziz Emini, përfaqësues i komunitetit rom;**
- 1.6 Adem Hoti, përfaqësues i komunitetit ashkali;**
- 1.7 Berat Maloku, përfaqësues i komunitetit turk.**

2. Komiteti për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera si dhe rregulloren e punës.

3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të komunës, përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet në mbledhjen e parë të komitetit, me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjedhet nga radhët e komuniteteve joshumicë.

6. Anëtarët e Komitetit për Komunitete, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë.

7. Ky vendimi hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Pas votimit të Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete, grupi kuvendar i LDK-së, në mënyrë demsotrativë lëshoj sallën e mbledhjes plenare, si rezultat i mospajtimit të tyre me mënyrën e votimit të kësaj pike të rendit të ditës. Në sallë mbeten 25 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

3. Propozim-vendim për aprovimin e listës së pronave komunale për vitin 2026;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota “për” 7 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

2. Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.

3. Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrisë në të ardhmen planifikon të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

6. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

4. Draft Plani i Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2026;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2026.

5. Draft Plani i Punës i Kryetarit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2026;

6. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25196/25 i datës 03.06.2025, për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. “Ismail Parduzy” në Vushtri, sipas gjendjes faktike;

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-deklaroi se për të gjitha pikat e rendit të ditës në vijim që janë anuluar nga MAPL-ja në mandatin e kaluar, grupi kuvendar i LVV-së ka qenë kundër e për të cilat kanë votuar kundër, në këtë rast nuk kemi nevojë të shfuqizojmë diçka që ka qenë e jashtëligjshme dhe si rezultat i kësaj farse ata lëshojnë mbledhjen e kuvendit duke bojkotuar votimin dhe prezencën në sallën e mbledhjes plenare.

Në vazhdim grupi kuvendar i LVV-së, në mënyrë demsotrativë lëshoj sallën e mbledhjes plenare, si rezultat i mospajtit të tyre me mënyrën e votimit të pikave që do të shfuqizohen që janë të renditura si në vijmë, për të cilat ata vlerësojnë se kur janë aprovuar ato vendim ato kanë qenë të paligjshme dhe nuk ka nevojë të shfuqizohet diçka që nga fillimi ka qenë nulë.

Në sallë mbeten 18 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit-duke ju referuar lëshimit të sallës së mbledhjes së kuvendit, grupi kuvendar i LVV-së, po i shmanget detyrave dhe përgjegjësisë, që ja ka dhënë qytetari. Kjo për faktin se nuk mundesh një herët të mundohesh të tregohesh parimor në kundërshtim dhe më pas të lëshosh sallën duke mos votuar për shfuqizimin e këtyre pikave. Ai vlerësoi se i vjen shumë keq që për herën e dytë ky grup del nga mbledhja duke i braktisur detyrat dhe përgjegjësitë që ja ka ngarkuar qytetari dhe ligji.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25196/25 i datës 03.06.2025, për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. “Ismail Parduzy” në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25199/25i datës 03.06.2025, Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private,

zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtri, sipas gjendjes faktike;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25199/25i datës 03.06.2025, Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Propozim-vendim për anulimin e vendimit me numër të protokollit Nr. 108/24 i datës 03.06.2024, lidhur me pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 108/24 i datës 03.06.2024, lidhur me pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.

3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 18/25 i datës 30.01.2025, me të cilin lejohet ndarja e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 18/25 i datës 30.01.2025, lidhur me cilin lejohet ndarja e mjeteve financiare për

furnizim me pako ushqimore në vlerë prej 100.00 € (njëqind euro) me rastin e festës së Fiter Bajramit, për zyrtarë të punësuar në Administratën e Komunës dhe anëtarë të kuvendit të komunës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 29309/25 i datës 26.06.2025 lidhur me miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin **Bastri-Hajzer Beqiri**, në sipërfaqe prej 100 m², pjesë nga parcela P-70202047-00576-0, nga sipërfaqja e përgjithshme 2100m² pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, ta adresoj këtë çështje duke e futur në Plan Zhvillimor Komunal ndërtimin e këtij lapidari.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Mbledhja përfundoi në ora 10:55.

Bastri Duraku


Procesmbajtës



Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit